

VENDIM
Nr. 666, datë 8.10.2014

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AUTORITETI
SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR (ASIG) TE KËSHILLI I
MINISTRAVE, PËR AGJENCINË E MBËSHTETJES SË SHOQËRISË CIVILE, TË
GODINËS SË OBSERVATORIT TË INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE DHE
ENERGJISË, UJIT E MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) të Këshilli i Ministrave, për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit për t’u përdorur si mjedise pune nga ky institucion, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Vendimi nr. 771, datë 5.9.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) të një pjese të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile dhe kryeregjistruesi i i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

